

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.05.2024*

**24.05.2024
Ora 12:13**

RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafii KQZ: Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.


Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, atëherë në seancën e sotme publike, kemi në rendin e ditës këto çështje:

- Projektvendimin Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë”;
 - Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë”;
 - Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër”;
 - Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Armelin Koni, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”.
 - Projektvendim “Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Leonard Hide, Kryetar Bashkie në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
- Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, po bëjeni relatimin për të tre vakancat.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.05.2024*

Znj. P. Doçaj: Faleminderit Kryetar! Këshillat e Bashkisë: Pukë, Rrogozhinë dhe Dibër, kanë njoftuar krijimin e vakancave në këshillat përkatës nga disa subjekte zgjedhore. Në referim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor kemi proceduar me verifikimin e kandidatëve të rradhës nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore përkatëse. Në referim të ligjit 138/2015 është verifikuar formulari i vetëdeklarimit i cili është dorëzuar brenda afateve ligjore nga të tre kandidatët. Ka rezultuar që nuk ka asnjë të dhënë që të bjerë ndesh me këtë ligj dhe për këtë motiv, ne kemi proceduar me verifikimin e mëtejshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Kemi marrë përgjigje nga këto institucione dhe ka rezultuar se dy kandidatë janë të rehabilituar, nga përgjigja e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ndërsa kandidati tjetër është i padënuar me vendim penal të formës së prerë. Për sa i përket gjendjes civile nuk kanë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Nisur sa më sipër dhe në kushtet ku nuk ka asnjë deklaram dhe nuk ka asnjë kusht që të bjerë ndesh me ligjin e dekriminalizimit, mendoj se janë në kushtet e zgjedhshmërisë si kandidat në funksionin e anëtarit të këshillit bashkiak.


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit “Partia Aleanca Demokratike Shqiptare”, zotin Alban Lleshi.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit “Partia Republikane Shqiptare”, zoti Isa Halili.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit “Partia Republikane Shqiptare”, zonjën Nertila Kaza.

Vendimet nr. 49, 50, 51.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.05.2024*

**24.05.2024
Ora 12:19**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Armelin Qazim Koni, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Progresiste LZHK”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera!

Znj. P. Doçaj: Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionarët publikë. Në kuadër të kësaj kompetence që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dhe në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve të datës 14 Maj 2023, zoti Armelin Qazim Koni, ka qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga Aleanca Progresiste LZHK. Në datën 30.03.2023 ka depozituar, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit. Pas verifikimit nga ana jonë “prima facie” të këtij formulari, nëpërmjet të cilit ky i fundit nuk ka deklaruar ndonjë të dhënë që të bjerë ndesh me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.05.2024*

ligjin, kemi proceduar dhe vijuar me verifikimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Nga Drejtoria e Burgjeve na ka ardhur rezultati dhe ka rezultuar i “rehabilituar”, ky kandidat. Po kështu nga verifikime të mëtejshme të formularit të dekriminalizimit, ka rezultuar që ky kandidat ka deklaruar në rubrikën III, se ka qenë i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë në Gjykatën e Triestes. Nisur pikërisht nga ky fakt, nga ky gjykim që vetë kandidati ka deklaruar, nga ana jonë është proceduar me dërgimin e këtij rasti për verifikim të thelluar në organin kompetent, pra në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga sa më sipër, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimet përkatëse dhe në përfundim të gjithë hetimit të plotë të bërë, ka miratuar verifikimin e rezultatit të këtij vendimi. Nga ky verifikim i Prokurorisë është konstatuar se kandidati ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë nga dy gjykata, përkatësisht: Gjykata e Romës dhe Gjykata e Triestes. Mendojmë t’ju propozojmë për faktin që ky kandidat nuk ka marrë asnjë mandat dhe nuk do të mund të fitonte asnjë mandat, sepse subjekti zgjedhor Aleanca Progresiste LZHK, nuk ka marrë asnjë mandat në Këshillin e Bashkisë Shijak, ju propozojmë që ta konsiderojmë të përfunduar shqyrtimin administrativ. Kjo në përputhje dhe me Kodin e Procedurës Administrative, pasi i ka rënë qëllimi i verifikimit.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Vendosim:

- Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim për subjektin vetëdeklarues zotin Armelin Qazim Koni.

Vendimi nr. 52

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.05.2024*

**24.05.2024
Ora 12:19**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, Kryetar Bashkie në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës!

Znj. P. Doçaj: Në zbatim të ligjit nr.138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin e funksionarëve publikë. Pikërisht lidhur me këtë kompetencë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka, në kuadër të zhvillimit të procesit zgjedhor të datës 14 Maj 2023 është propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për kryetar në Bashkinë Libohovë, zoti Leonard Hide. Në kuadër të verifikimit të kryer nga ana e KQZ-së është verifikuar formulari i dekriminalizimit i depozituar brenda afateve kohore, në datën 31.03.2023, nga ku ka rezultuar që nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë nga vetë kandidati. Po kështu është vijuar me verifikime të mëtejshme duke ju drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.05.2024*

Gjendjes Gjyqësore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Nga ana e tyre është kthyer përgjigje brenda afateve ligjore dhe ka rezultuar që kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë dhe nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Rezulton se për këtë kandidat, në KQZ është depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, një shkresë në datën 16.05.2024, nëpërmjet së cilës informohet KQZ-ja se ky kandidat ka qenë në hetim në vitin 2021 nga Prokuroria e Gjirokastrës për çështjen e kanabizimit të Qarkut të Gjirokastrës. Në këtë kohë ky kandidat, ka ushtruar funksionet në Policinë e Shtetit dhe sipas Partisë Demokratike, rezulton që të mos e ketë deklaruar pikërisht këtë të dhënë në formularin e dekriminalizimit. Kjo e dhënë ka të bëjë vetëm në hetimin në Prokurorinë e Gjirokastrës, pasi rezulton, gjithnjë sipas të dhënave të shkresë së Partisë Demokratike, që ky hetim ka vazhduar më pas për kompetencë në SPAK e më tej është përcjellë në Gjykatën e Posaçme. Kjo është një indicie që na vjen nga Partia Demokratike dhe për këtë motiv ne çmojmë që është e nevojshme që të merren informacione të mëtejshme dhe të përcillet rasti për verifikim në Prokurorinë e Përgjithshme, në referim edhe të vendimit të Kuvendit. Nuk jemi ne organi kompetent për verifikimet e plota të deklarimeve të bëra në formularin e dekriminalizimit, por është një strukturë e posaçme ajo në Prokurorinë e Përgjithshme, që është Drejtoria e Koordinimit Instuticional, Sektori i Dekriminalizimit.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, bazuar në çfarë u relatua, mendojmë që është rasti për të kërkuar verifikimin e thelluar të subjektit vetëdeklarues zotit Leonard Hide, kryetar në Bashkinë Libohovë, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Për këtë arsye, rrjedhimisht dërgimin e të dhënave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.

Çështje të tjera nuk kemi, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 53

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

